



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
“CHARLES TELFORD ERICKSON”

Golem — Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0693870484 .

Nr 410 prot

Golem më 14, 09, 2024.

Lenda:Njoftim per vend te lire pune.

**Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore
Drejtoria e Maredhenieve me Publikun
Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive**

Në mbështetje të Ligjit nr.15/2019 “Per nxitjen e punesimit”, Ligjit nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimitnr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, Udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,

Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson” Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit te lire per pozicionin:

-Mesimedhene i teorise profesionale per drejtimin:Hoteleri Turizem.

Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kriteret të përgjithshme:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyren.

- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e veprave penale.
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-se.
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushen, në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi.
- c) Kartën e identitetit.
- d) Diplomën;
- e) Librezën e punës;
- f) Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- g) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 24 . 09 .2024.

Drejtore

Matilda Canaku

